

2021192806

Në bazë të nenit 48 paragrafi 1 pika 3 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 110/21,,), pika 47 nga Vendimi për kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 149/21) dhe Vendimi për përcaktimin e rendit në bazë të cilit viceguvernatorët do ta zëvendësojnë guvernatorin gjatë mungesës së tijë nga puna ose pengesës për kryerjen e obligimeve në punë gjatë viti 2021, Nr. 04-481/1 nga 8 janari i viti 2021, viceguvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

UDHËZIM PËR ZBATIMIN E VENDIMIT PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E FURNIZIMIT ME KARTËMONEDHA DHE MONEDHA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzim rregullohet zbatimi i Vendimit për kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha, nëpërmjet:

- përshkrimit të mënyrës së furnizimit me kartëmonedha dhe monedha të cilat janë mjet për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: para të gatshme);
- përshkrimit të procedurës për përcaktim të dallimeve në dërgesë (mungesë dhe tepëri);
- përshkrimit të lajmërimit për kontrollë të autenticitetit dhe përshtatshmërisë, kushteve dhe mënyrës së kthimit të kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim;
- përcaktimit të formës dhe përmbajtjes së formularëve – kërkesave që dorëzohen tek Banka Popullore për testim të makinave për përpunimin e parave dhe kërkesave për trajnim të punonjësve për aftësimin e përpunimit e parave dhe përcaktimin e autenticitetit dhe përshtatshmërisë së tyre për qarkullim.

II. MËNYRA E FURNIZIMIT ME PARA TË GATSHME

2. Furnizimi me paratë e gatshme kryhet me anë të tërheqjes së kartëmonedhave dhe monedhave nga Banka Popullore, transportit deri te përdoruesit, mbledhja e parave të gatshme nga përdoruesit, përpunimi, paketimi dhe kthimi i parave të gatshme në Bankën Popullore nga bankat dhe kompanitë për furnizimin me para të gatshme (në tekstin e mëtejshëm: qendrat për para të gatshme).

3. Orari i punës në Bankën Popullore për punë me bankat dhe qendrat për para të gatshme është nga ora 8:30 deri në orën 15:30, çdo ditë pune, nga e hëna deri të premten.

4. Bankat të cilat tërheqin para të gatshme nga Banka Popullore, paguajnë mjete financiare nga llogaria e tyre nëpërmjet Sistemit të Pagesave Ndërbankarë të Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: MIPS) në llogari të veçantë të Bankës Popullore për shumën që ata dëshirojnë ta tërheqin.

Qendrat për para të gatshme që tërheqin para të gatshme nga Banka Popullore, kryejnë pagesë të mjeteve nga llogaria e tyre në llogari të veçantë të Bankës Popullore.

5. Sipas pagesës së kryer, bankat dhe qendrat për para të gatshme dorëzojnë informata për strukturën nominale të parave të gatshme që duan të tërheqin dhe kohën e tërheqjes së parave të gatshme nëpërmjet telefaksit, e-postës apo telefonit.

Me qëllim të vendosjes së strukturës nominale optimale të parave të gatshme në qarkullim, Banka Popullore mund të ndryshojë informacionin e dorëzuar për strukturën nominale të parave të gatshme dhe të paguajë para të gatshme me strukturë nominale të ndryshme nga ajo e kërkuara. Për ndryshimin e strukturës së nominale të parave të gatshme, Banka Popullore i njofton bankat dhe qendrat për para të gatshme.

6. Tërheqje të parave të gatshme mund të bëjnë personat që kanë autorizim për tërheqje të parave të gatshme nga organi përkatës i udhëheqjes së bankave ose qendrave për para të gatshme.

Bankat dhe qendrat për para të gatshme janë të obliguara në fillim të çdo viti, të dorëzojnë pasqyrë të verifikuar të personave të autorizuar të cilët do të tërheqin dhe kthejnë para të gatshme nga/në Banka Popullore, e cila përmban këto të dhëna të personave të autorizuar: emër dhe mbiemër, numër të letërnjoftimit dhe banka/qendra për para të gatshme që ka lëshuar autorizimin. Qendrat për para të gatshme, së bashku me pasqyrën e verifikuar të personave të autorizuar, dorëzojnë edhe kopje të kontratës për furnizim me para të gatshme.

Në rast të autorizimit të personit të ri ose marjen e autorizimit personit të autorizuar, bankat dhe qendrat për para të gatshme janë të obliguara të dorëzojnë tek Banka Popullore njoftim me të dhënat për personin e ri të autorizuar, përkatësisht personit që i është marur autorizimi. Njoftimi për personin të cilit i është marur autorizimi dorëzohet në afat prej jo më shumë se 1 ditë nga dita e marjes së autorizimit.

Pasqyra dhe njoftimet nga paragrafi 2 i kësaj pike, ruhen 5 vite.

Gjatë tërheqjes së parave të gatshme, personat e autorizuar me vete duhet të kenë dokument për identifikim.

Përveç personave të autorizuar, hyrja për personat tjerë në Drejtorinë e Thesarit nuk është e lejuar.

7. Para të gatshme mund të tërhiqen më shumë herë gjatë një dite pune, me ç'rast për çdo tërheqje duhet kryer pagesa në llogari të veçantë të Bankës Popullore. Tërheqja e parave pas kryerjes së pagesës nuk mund të kryhet në afat kohor më të shkurt se 1 orë nga momenti i dorëzimit të informatës për nevojë të strukturës nominale.

Gjatë tërheqjes së parave të gatshme, personat e autorizuar të bankave dhe qendrave për para të gatshme janë të obliguar që në prani të personave të autorizuar nga Banka Popullore të numërojnë parat e gatshme sipas shënimeve në paketim.

8. Parat e gatshme janë të paketuara në pako (1 pako përmban 1.000 copë kartëmonedha) ose paketim prej 10.000 copë kartëmonedha, në të cilat ka etiketë me këto të dhëna: lloji i i prerjes, numri i copëve, vlerës nominale, nënshkrimi i punonjësve të cilët e kanë paketuar pakon dhe data e paketimit.

Sasia minimale e tërheqjes së monedhave është një thes/qese plastike me 500 copë.

9. Për tërheqjen e parave të gatshme përgatitet një fletë-dërgesë në denarë e cila pas numërimit të parave dhe të gatshme dhe përcaktimin e saktësisë së parave të pranuar, nënshkruhet dhe regjistrohet nga personat e autorizuar nga Banka Popullore dhe personave të autorizuar të bankave dhe qendrave për para të gatshme.

Fletë-dërgesa përgatitet në tre kopje, dy prej të cilave për Bankën Popullore dhe një për bankat dhe qendrat për para të gatshme.

10. Paratë e gatshme që kthehen në bankën Popullore, duhet të jenë të përpunuara dhe të paketuara në mënyrën e duhur.

Bankat dhe qendrat për para të gatshme janë të obliguara që kartëmonedhat dhe monedhat e konsumuara dhe dëmtuara t'i paketojnë veçmas dhe t'i ndajnë sipas kriterëve të përcaktuara nga Banka Popullore.

Fashetat e letrës, etiketimet e pakove dhe të dhënat e dërgesës së nënshkruar tek paratë e konsumuara, lidhen me vija të kryqëzuara.

Paratë e dëmtuara të cilat janë ndarë nga bankat dhe qendrat për para të gatshme dorëzohen në Bankën Popullore veçmas, të cilat përmbajnë të dhëna për bankën dhe qendrën për para të gatshme, vlerën nominale, strukturën dhe kanë shënim "para të konsumuara".

Të gjitha kartëmonedhat, përveç të dëmtuarave, duhet të jenë të paketuara sipas prerjes, të kthyera në një anë dhe pamje, nga 100 copë në macetë, 10 maceta në një pako prej 1000 copë dhe 10 pako të paketuara në një dërgesë të nënshkruar me gjithsej 10.000 copë.

Në fashetat e letrës së macetave, duhet patjetër të ketë të dhëna të bankës dhe të qendrës për para të gatshme të cilët kanë përpunuar macetën, data e paketimit, prerja, numri i copëve (100), vlera nominale dhe nënshkrimi ose shifra e dy personave të cilët i kanë përpunuar dhe kontrolluar macetat.

Dhjetë maceta formojnë pako prej 1.000 copëve nga vlera nominale e njëjtë dhe lidhen me makinë për lidhje (me fashetë letre të vendosur në kryq) apo vakumim. Në çdo pako vendoset data e paketimit me nënshkrimin e dy personave të cilët kanë kryer numërimin dhe lidhjen apo vakumimin.

Paketimi i nënshkruar prej 10.000 copëve, duhet patjetër të jetë paketuar në mënyrë të sigurt. Në dërgesën e nënshkruar shënohen emri i bankës dhe qendrës për para të gatshme, sasia, vlera nominale, prerja, data e paketimit dhe nënshkrimi i personave që kanë kryer paketimin.

Bankat dhe qendrat për para të gatshme, monedhat i dorëzojnë në Bankën Popullore të paketuara në mënyrën e paraparë në pikën 8 të këtij udhëzimi.

11. Banka Popullore kontrollon dhe numëron paratë e gatshme që pranon nga bankat dhe qendrat për para të gatshme, sipas të dhënave në paketim.

12. Sasia minimale për kthimin e kartëmonedhave në Bankën Popullore nga bankat dhe qendrat për para të gatshme, është 1 pako (1.000 copë).

Sasia minimale për kthimin e monedhave në Bankën Popullore nga bankat dhe qendrat për para të gatshme, është 1 thesë/qese plastike me 500 copë.

13. Gjatë kthimit të parave të gatshme, bankat dhe qendrat për para ë gatshme dorëzojnë formular të nënshkruar, fletë-dërgesë, e cila pas numërimit të parave të gatshme, nënshkruhet nga personat e autorizuar nga Banka Popullore.

Për kthimin e e parave të gatshme, Banka Popullore përgatitet një fletë-dërgesë në denarë e cila nënshkruhet dhe regjistrohet nga personat e autorizuar nga bankat dhe qendrat për para të gatshme dhe personave të autorizuar në Bankën Popullore.

Fletë-dërgesa përgatitet në dy kopje, njëra prej të cilave për Bankën Popullore dhe një për bankat dhe qendrat për para të gatshme.

14. Banka Popullore paguan shumën e parave të gatshme të pranuar nga banka nëpërmjet MIPS, në llogari të bankës, ndërsa për qendrat për para të gatshme paguan në llogarinë e tyre në bankën e autorizuar.

III. MËNYRA E PËRCAKTIMIT TË DALLIMEVE NË DËRGESA (MUNGESË DHE TEPRICË)

15. Pas pranimit të parave të gatshme, në Bankën Popullore kryhet kontroll i detajuar dhe numërim i parave të gatshme (në tekstin e mëtejshëm: përpunim).

Gjatë përpunimit të parave të gatshme, në qoftë se konstatohet mungesë, përkatësisht tepricë, përpilohet një raport për diferencën e konstatuar në dërgesë. Raporti përmban këto elemente:

- emri i bankës dhe qendrës për para të gatshme nga e cila janë pranuar paratë e gatshme;
- shuma e diferencës së konstatuar;
- numri i copëve dhe struktura nominale;
- data e përpunimit të diferencës së konstatuar;
- emri dhe mbiemri i punonjësve të cilat kanë përpunuar paratë e gatshme;
- vërejtje.

Raportit i bashkëngjitet shënimi i paketimit.

Si mungesë trajtohen edhe paratë e gatshme të bankave dhe qendrave për para të gatshme të cilat gjatë përpunimit dhe ekspertizës vërtetohet se janë të falsifikuara, dhe të njëjtat do të konfiskohen.

16. Nëse gjatë përpunimit të parave të gatshme që janë të shënuara si të konsumuara apo dëmtuara, gjenden ekzemplarë që nuk i përmbushin kriteret e parapara nga Banka Popullore, ekzemplarët e tillë do të do të trajtohen si mungesë.

17. Bankat dhe qendrat për para të gatshme janë të obliguara që të kompensojnë diferencën e konstatuar në dërgesë në bazë të raportit nga pika 15 e këtij udhëzimi.

Teprica e konstatuar nga dërgesa e parave të gatshme i kthehet bankës ose qendrës për para të gatshme, sipas raportit të përgatitur.

IV. NJOFTIM PËR KONTROLLË TË AUTENTICITETIT DHE PËRSHTATSHMËRISË, KUSHTEVE DHE MËNYRËS SË KTHIMIT TË KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE NË QARKULLIM

Mbledhja e të dhënave

18. Të dhënat që bankat dhe qendrat për para të gatshme kanë obligim ti dorëzojnë tek Banka Popullore, janë të paraqitura në shtojcat 1, 2, 3 dhe 4, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

19. Varësisht nga natyra, të dhënat që dorëzohen janë të ndara në të dhëna kryesore – bazë dhe të dhëna operative.

Të dhënat kryesore japin informacione për bankat dhe qendrat për para të gatshme të cilat bëjnë përpunimin e parave.

Të dhënat operative japin informata për parat e përpunuara dhe për kthimin e parave në qarkullim.

Të dhënat operative dorëzohen sipas numrit të copëve, totalit, sipas tremujorit dhe sipas prerjes.

Të dhënat dorëzohen tek Banka Popullore çdo tremujor, deri ditën e 15 pas mbarimit të tremujorit për të cilin dorëzohen të dhënat.

Formularët për dorëzim të të dhënave janë të përbëra prej të dhënave të grupuara të cilat bankat dhe qendrat për para të gatshme duhet ti plotësojnë dhe do të jenë të disponueshme në internet faqen e Bankës Popullore.

Të dhënat kanë të bëjnë me llojin dhe numrin e makinave për përpunim të parave, lokacioni i secilës makinë për përpunimin e parave, si dhe numri dhe vlera e parave të përpunuara nëpërmjet makinave për përpunimin e parave si dhe numri dhe vlera e parave të përpunuara në mënyrë manuele.

Dorëzimi i kërkesave tek Banka Popullore

20. Të dhënat që kanë të bëjnë me punën e makinave për përpunim të parave, të cilat banka, qendra për para të gatshme, prodhuesi, furnizuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i dorëzon në Bankën Popullore, janë të shënuara në formularin në shtojcën 5 – Kërkesë për kontrollim të punës së makinave për përpunimin e parave.

21. Kërkesa për trajnim të punonjësve për kontrollë të parave për tu dëshmuar autenticiteti dhe përshtatshmeria e tyre për qarkullim, dorëzohet në formularin në shtojcën 6 – Kërkesë për trajnim të punonjësve për përpunim të parave.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

22. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, Udhëzimi për përcaktimin e mënyrës dhe procedurës për furnizim të bankave me kartëmonedha dhe monedha („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 118/15 dhe 6/17) dhe Udhëzimi për zbatimin e Vendimit për kontrollë të autenticitetit dhe përshtatshmërisë, kushtet dhe mënyra e kthimit të kartëmonedhave

dhe monedhave në qarkullim dhe mënyra e mkikqyrjes („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 69/17) pushojnë së qenuri të vlefshëm.

23. Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

U. nr. 11-22553/1
22 qershor viti 2021
Shkup

Viceguvernator
Dr. Fadil Bajrami

Shtojca nr.1

TË DHËNA PËR QARKULLIMIN E REALIZUAR TË PARAVE**1. TË DHËNA PËR BANKËN**

Emri dhe selia:	
Emri dhe mbiemri i personit për kontakt:	
Numri i telefonit:	
Adresa elektronike:	

2. PERIUDHA PËR TË CILËN DORËZOHEN TË DHËNAT

--

3. TË DHËNA PËR QARKULLIMIN E PARAVE*Kartëmonedha*

Vlera nominale	Arka		Makinat për pagesë të kartëmonedhave	
	Gjithsej të paguara nga arka	Gjithsej paguara në arkë	Gjithsej të paguara nga arka	Gjithsej të paguara në arkë
10 denarë				
50 denarë				
100 denarë				
200 denarë				
500 denarë				
1000 denarë				
2000 denarë				
Gjithsej:				

Monedha

Vlera nominale	Gjithsej të paguara nga arka	Gjithsej të paguara në arkë
1 denar		
2 denare		
5 denarë		
10 denarë		
50 denarë		
Gjithsej:		

Shënim: Në tabela shënohet shuma totale e copëve të kartëmonedhave dhe monedhave në nivel të bankës.

Vula

(vendi dhe data)

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi i personit përgjegjës)

TË DHËNA PËR PARATË E PËRPUNUARA**1. TË DHËNA PËR BANKËN/QENDRËN PËR PARA TË GATËSHME**

Emri dhe selia:	
Emri dhe mbiemri i personit për kontakt:	
Numri i telefonit:	
Adresa elektronike:	

2. PERIUDHA PËR TË CILËN DORËZOHEN TË DHËNAT

--

3. TË DHËNA PËR PARATË E PËRPUNUARA*Kartëmonedhat e përpunuara në makina:*

Vlera nominale	Gjithsej të përpunuara	Të përshtatshme për qarkullim	Të papërshtatshme për qarkullim
10 denarë			
50 denarë			
100 denarë			
200 denarë			
500 denarë			
1000 denarë			
2000 denarë			
Gjithsej:			

Kartëmonedhat e përpunuara në mënyrë manuale:

Vlera nominale	Gjithsej të përpunuara	Të përshtatshme për qarkullim	Të papërshtatshme për qarkullim
10 denarë			
50 denarë			
100 denarë			
200 denarë			
500 denarë			
1000 denarë			
2000 denarë			
Gjithësej:			

Monedhat e përpunuara në makina:

Vlera nominale	Gjithsej të përpunuara	Të përshtatshme për qarkullim	Të papërshtatshme për qarkullim
1 denar			
2 denarë			
5 denarë			
10 denarë			
50 denarë			
Gjithsej:			

Monedhat e përpunuara në mënyrë manuale:

Vlera nominale	Gjithsej të përpunuara	Të përshtatshme për qarkullim	Të papërshtatshme për qarkullim
1 denar			
2 denarë			
5 denarë			
10 denarë			
50 denarë			
Gjithsej:			

(vendi dhe data)

Vula

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi i personit përgjegjës)

Shtojca nr.3

**TË DHËNA PËR MAKINAT ME TË CILAT DISPONON
BANKA/QENDRA PËR PARA TË GATËSHME**

1. TË DHËNA PËR BANKËN/QENDRËN PËR PARA TË GATËSHME

Emri dhe selia:	
Emri dhe mbiemri i personit për kontakt:	
Numri i telefonit:	
Adresa elektronike:	

2. MAKINAT ME TË CILËN UDHËHEQIN KLIENTËT E BANKËS

Lloji	Prodhesi	Emri i makinës	Emërtimi i harduerit dhe softuerit	Numri serik	Vendi dhe adresa ku ndodhen makinat
CIM					
CRM					
CCM					
COM					
TARM ⁽¹⁾					
TAM(1)					

3. MAKINAT ME TË CILËN UDHËHEQIN PUNONJËSIT E TRAJNUAR

Lloji	Prodhesi	Emri i makinës	Emërtimi i harduerit dhe softuerit	Numri serik	Vendi dhe adresa ku ndodhen makinat
BPM					
BAM					
TARM					
TAM					

4. MAKINAT PËR PËRPUNIMIN E MONEDHAVE

Lloji	Prodhesi	Emri i makinës	Emërtimi i harduerit dhe softuerit	Numri serik	Vendi dhe adresa ku ndodhen makinat
CPM					

5. MAKINAT PËR TËRHEQJEN E KARTËMONEDHAVE (bankomate)

Lloji	Prodhesi	Emri i makinës	Emërtimi i harduerit dhe softuerit	Numri serik	Vendi dhe adresa ku ndodhen makinat
ATM					

Shënim: Nëse banka/qendra për para të gatshme posedon më shumë makina apo pajisje të llojit të njëjtë, shënohen veçmas, njëra pas tjetrës.

Vula

(vendi dhe data)

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi i personit përgjegjës)

¹ Kur përdoren nga klientët e bankës

Shtojca 4

TË DHËNA PËR PARAT E PËRPUNUARA

1. TË DHËNAT BAZË

Të dhëna për bankën/qendrën për para të gatshme e cili kryen përpunimin e parave

Emri dhe selia:	
Numri amë:	
Adresa:	
Emri dhe mbiemri i personit për kontakt:	
Numri i telefonit:	
Adresa elektronike:	

Të dhëna për shfrytëzuesin e shërbimit

Emri dhe selia:	
Adresa:	
Emri dhe mbiemri i personit për kontakt:	
Numri i telefonit:	
Adresa elektronike:	

2. TË DHËNA OPERATIVE PËR PARAT E PËRPUNUARA

Periudha për të cilën dorëzohet raporti	
---	--

Shënim: Në tabelat e ardhshme, është e nevojshme të shënohet numri i kartëmonedhave dhe monedhave të përpunuara.

1) Të dhëna për përpunimin e parave me makina

Kartëmonedha

Vlera nominale	Gjithsej të përpunuara	Të përshtatshme për qarkullim	Të papërshtatshme për qarkullim
10 denarë			
50 denarë			
100 denarë			
200 denarë			
500 denarë			
1000 denarë			
2000 denarë			
Gjithsej:			

Monedha

Vlera nominale	Gjithsej të përpunuara	Të përshtatshme për qarkullim	Të papërshtatshme për qarkullim
1 denar			
2 denarë			
5 denarë			
10 denarë			
50 denarë			
Gjithsej:			

2) Të dhëna për përpunimin manual të parave

Kartëmonedha

Vlera nominale	Gjithsej të përpunuara	Të përshtatshme për qarkullim	Të papërshtatshme për qarkullim
10 denarë			
50 denarë			
100 denarë			
200 denarë			
500 denarë			
1000 denarë			
2000 denarë			
Gjithsej:			

Monedha

Vlera nominale	Gjithsej të përpunuara	Të përshtatshme për qarkullim	Të papërshtatshme për qarkullim
1 denar			
2 denare			
5 denarë			
10 denarë			
50 denarë			
Gjithsej:			

3) Të dhëna për qarkullimin e parave*Kartëmonedha*

Vlera nominale	Të pranuar nga shfrytëzuesit e shërbimit	Të dorëzuara nga shfrytëzuesit e shërbimit
10 denarë		
50 denarë		
100 denarë		
200 denarë		
500 denarë		
1000 denarë		
2000 denarë		
Gjithsej:		

Monedha

Vlera nominale	Të pranuar nga shfrytëzuesit e shërbimit	Të dorëzuara nga shfrytëzuesit e shërbimit
1 denar		
2 denare		
5 denarë		
10 denarë		
50 denarë		
Gjithsej:		

Vula

(vendi dhe data)

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi i personit përgjegjës)

Shtojca 5

KËRKESË PËR KONTROLLIM TË PUNËS SË MAKINAVE PËR PËRPUNIMIN E PARAVE

TË DHËNA PËR DORËZUESIN E KËRKESËS	
Emri dhe selia:	
Adresa:	
Emri dhe mbiemri i personit për kontakt:	
Numri i telefonit:	
Adresa elektronike:	

TË DHËNA PËR PRODHUESIN E MAKINAVE	
Prodhuesi:	
Adresa:	
Adresa elektronike:	
Numri i telefonit	

TË DHËNA PËR MAKINËN	
Emri – lloji:	
Modeli:	
Versioni:	
Versioni i softuerit:	
Numri i fabrikës:	
Makina përpunon:	☐ kartëmonedha të emetuara nga BPRM ☐ monedha të emetuara nga BPRM
Cilat vlera nominale të kartëmonedhave i përpunon makina?	☐ 10 den. ☐ 50 den. ☐ 100 den. ☐ 200 den. ☐ 500 den. ☐ 1000 den. ☐ 2000 den.
Cilat vlera nominale të monedhave i përpunon makina?	☐ 1 den. ☐ 2 den. ☐ 5 den. ☐ 10 den. ☐ 50 den.
Klasifikimi i makinave	☐ makinat me të cilat udhëheqin klientët e bankave ☐ makinat me të cilat udhëheqin punonjësit e trajnuar
<i>Pyetje për makinat me të cilat udhëheqin klientët e bankës:</i>	☐ po ☐ jo

A i ruan makina të dhënat e pronarit të llogarisë dhe parave të dyshuara të konfiskuara, përkatësisht a egziston lidhja në mes kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara të konfiskuara dhe deponentit?	
Tipi i makinës:	☐ Makinat për depozitimin e parave të gatshme (CIM) ☐ Makinat për depozitim dhe tërheqje të parave të gatshme (CRM) ☐ Makinat e kombinuara për depozitimin e parave të gatshme (CCM) ☐ Makinat për tërheqjen e parave të gatshme (COM) ☐ Makina për përpunimin e kartëmonedhave (BPM) ☐ Makina e autentifikimit të kartëmonedhave (BAM) ☐ Makina për përpunimin e monedhave (CPM) ☐ Makinat për depozitimin e monedhave
Makina në mënyrë automatike i përpunon parat dhe i kategorizon në të përshtatshme, të papërshtatshme dhe të refuzuara, përkatësisht të dyshuara, pa intervenim nga ana e udhëheqësit të makinës	☐ po ☐ jo
Makina ka pjesë të ndara për përpunim të kartëmonedhave dhe monedhave:	☐ po ☐ jo
Nëse përgjigjja e pyetjes paraprake është negative, sqaroni se si makina selekton dhe regjistron kartëmonedha dhe monedha të përshtatshme, të papërshtatshme dhe të dyshuara sipas moduleve dalësegjate përpunimit	☐ po ☐ jo
A janë të dukshem në makinë të dhënat për vlerën nominale të parave që përpunon ajo makinë?	☐ po ☐ jo
A janë të dukshme informatat në makinë për vlerat nominale që përpunon ajo makinë?	a) po b) jo
Numri i orientacioneve të parave gjatë përpunimit	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4
Cilat elemente të sigurisë tek kartëmonedhat kontrollon makina?	☐ UV ☐ IR ☐ magnetizëm ☐ _____
Kush është i autorizuar për të vendosur parametrat për autentifikim dhe	☐ operatori ☐ personi i autorizuar për mirëmbajtje

karakteristikat fizike të kartëmonedhave tek makinat?	☐ prodhuesi i makinave ☐ _____
Karakteristikat teknike të makinës dhe udhëzimi për punë të makinës dorëzohen së bashku me kërkesën e plotësuar	☐ po ☐ jo
Për punë të sigurt të makinës, janë të nevojshme servisimet në inetrvale:	☐ javor ☐ mujor ☐ gjysmëvjetor ☐ vjetor ☐ të herëpashërëshme
A ekziston mundësia që makina në mënyrë plotësuese të përshtatet për kartëmonedha me prerje të reja?	☐ po ☐ jo
A ekziston mundësia që makina në mënyrë plotësuese të përshtatet për zbulim të parave të falsifikuara të reja?	☐ po ☐ jo

(vendi dhe data)

Vula

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi i personit përgjegjës)

Shtojca 6

**KËRKESE PËR TRAJNIM TË PUNONJËSVE
PËR PËRPUNIMIN E PARAVE**

TË DHËNA PËR PARASHTRUESIN E KËRKESES:	
Emri dhe selia:	
Njësia organizative:	
Adresa:	
Emri dhe mbiemri i personit për kontakt:	
Numri i telefonit:	
Adresa elektronike:	

Të dhëna për punonjësin:			
Numri rendor	Emri dhe mbiemri	Vendi i punës	Numri i letrës së njoftimit

(vendi dhe data)

Vula

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi i personit përgjegjës)